

DOKU FEST

**Organizata Joqeveritare
DOKUFEST**

**Raporti i auditorit të pavarur dhe pasqyrat financiare individuale
për vitin që përfundoi më 31 dhjetor 2023**

PËRMBAJTJA

FAQE

RAPORTI I AUDITORIT

PASQYRA E POZICIONIT FINANCIAR

5

PASQYRA E TË ARDHURAVE GJITHËPËRFSHIRËSE

6

PASQYRA E NDRYSHIMEVE NË GJENDJEN E FONDEVE

7

PASQYRA E RRJEDHJES SË PARASË

8

SHËNIMET E PASQYRAVE FINACIARE

9-21



Rr. Bekim Fehmiu
Icon Tower, Kati 11, Nr.110
Prishtinë
T: +383 48 211 687
E: info@acaauditing.com
W: acaauditing.com

RAPORTI I AUDITORIT TË PAVARUR

Drejtuar menaxhmentit të DOKUFEST

Opinion

Ne kemi audituar pasqyrat financiare shoqëruese të DOKUFEST, të cilat përbëhen nga pasqyra e pozicionit financiar më 31 dhjetor 2023, pasqyra e të ardhurave gjithëpërfshirëse, pasqyra e ndryshimeve në gjendjen e fondeve dhe pasqyra e rrjedhës së parasë për vitin që ka përfunduar në atë datë, si dhe një përmbledhje të politikave të kontabilitetit dhe shënimeve tjera shpjeguese.

Sipas opinionit tonë, pasqyrat financiare paraqesin drejtë në të gjitha aspektet materiale, pozitën financiare të DOKUFEST me 31 dhjetor 2023 dhe të performancës financiare dhe rrjedhës së parasë së gatshme për vitin financiar që ka përfunduar në atë datë në përputhje me Ligjet aktuale në fuqi.

Baza për Opinion

Ne kemi kryer auditimin në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit (SNA). Përgjegjësitë tona sipas këtyre standardeve janë përshkruar më tej në seksionin e raportit Përgjegjësitë e Auditorit për Auditimin e Pasqyrave Financiare. Ne jemi të pavarur nga Organizata në përputhje me Kodin e Etikës për Kontabilistët Profesionistë (Kodit IESBA) dhe kemi përmbushur përgjegjësitë tjera etike në përputhje me Kodin IESBA. Ne besojmë se evidenca e auditimit që kemi siguruar është e mjaftueshme dhe e përshtatshme për të ofruar bazat për opinionin tonë.

Përgjegjësitë e menaxhmentit dhe personave që janë të ngarkuar me qeverisjen e pasqyrave financiare

Menaxhmenti është përgjegjës për përgatitjen dhe prezantimin e drejtë të këtyre pasqyrave financiare në pajtueshmëri me Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar dhe për kontrollet e brendshme të cilat menaxhmenti i vlerëson të nevojshme për të mundësuar përgatitjen e pasqyrave financiare pa gabime materiale, për shkak të mashtrimit apo gabimit.

Në përgatitjen e pasqyrave financiare, menaxhmenti është përgjegjës për vlerësimin e aftësisë së organizatës për vazhdueshmërinë në të ardhmen, duke shpalosur, sipas nevojës, çështjet lidhur me vazhdueshmërinë në të ardhmen dhe përdorimin e parimit të vazhdueshmërisë së kontabilitetit përveç nëse menaxhmenti synon të likuideojë Organizatën, ndërpres operimin, apo nuk ka ndonjë alternativë tjetër të mundshme përveç se të bëjë atë.

Ata të cilët janë ngarkuar me qeverisje janë përgjegjës për mbikëqyrjen e procesit të raportimit financiar të Organizatës.

Përgjegjësitë e auditorit për auditimin e pasqyrave financiare

Objektivat tona janë për të marrë siguri të arsyeshme nëse pasqyrat financiare si tërësi janë të lira nga gabimet materiale, për shkak të mashtrimit apo gabimit, dhe për të nxjerrë një raport të auditorit që përfshin opinionin tonë. Siguria e arsyeshme është nivel i lartë i sigurisë, por nuk ka garanci që një auditim i kryer në përputhje me SNA-të gjithmonë do të zbulojë gabime materiale kur ato ekzistojnë.

Gabimet mund të rrjedhin nga mashtrimet apo gabimet tjera dhe konsiderohen materiale nëse, individualisht ose në total, ato në mënyrë të arsyeshme mund të pritet të ndikojnë në vendimet ekonomike të përdoruesve të marra mbi bazën e këtyre pasqyrave financiare.

Si pjesë e një auditimi në përputhje me SNA-të, ne ushtrojmë gjykimin profesional dhe mbajmë skepticizmin profesional gjatë auditimit. Ne gjithashtu:

- Identifikojmë dhe vlerësojmë rrezikun e gabimeve materiale në pasqyrat financiare, për shkak të mashtrimit apo gabimit, dizajnojmë dhe kryejmë procedurat e auditimit të përshtatshme për këto rrezeqe. Ne marrim dëshmi të auditimit të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të ofruar bazat për opinionin tonë. Rreziku i mos zbulimit të gabimeve materiale që rezulton nga mashtrimi është më i lartë se i atij që rrjedh nga gabimi, pasi mashtrimi mund të përfshijë marrëveshje të fshehta, falsifikim, lëshime të qëllimshme, keqinterpretime apo shkelje të kontrolleve të brendshme.
- Përfitojmë njohuri mbi kontrollet e brendshme që janë relevante për auditim me qëllim të hartimit të procedurave të auditimit që janë të përshtatshme në rrethanat, por jo për qëllim të shprehjes së një opinioni mbi efektivitetin e kontrolleve të brendshme të Organizatës.
- E vlerësojmë përshtatshmërinë e politikave kontabël të përdorura, arsyeshmërinë e vlerësimeve kontabël dhe shpalosjet relevante të bëra nga menaxhmenti.
- Konkludojmë mbi përshtatshmërinë e përdorimit të parimit të vazhdueshmërisë së kontabilitetit nga menaxhmenti, duke u bazuar në dëshmitë e siguruara të auditimit, nëse një pasiguri materiale ekziston në lidhje me ngjarjet apo kushtet që mund të hedhë dyshime të konsiderueshme mbi aftësinë e organizatë për të vazhduar në vijimësi. Nëse arrijmë në përfundimin se një pasiguri materiale ekziston, ne jemi të detyruar të tërheqim vëmendjen në raportin tonë të auditimit për shpalosjet relevante në pasqyrat financiare apo nëse shpalosjet e tilla janë të papërshtatshme, të modifikojmë opinionin tonë. Konkluzionet tona bazohen në evidencat e auditimit të marra deri në datën e raportit të auditimit. Megjithatë, ngjarjet ose kushtet në të ardhmen mund të shkaktojnë që organizata të pushojë së vazhduari në vijimësi.
- Vlerësojmë paraqitjen e përgjithshme, strukturën dhe përmbajtjen e pasqyrës financiare, përfshirë shpalosje nëse pasqyra financiare përfaqëson transaksionet dhe ngjarjet përkatëse në mënyrë që të arrijë paraqitjen e drejtë.

Ne komunikojmë me ata që janë të ngarkuar me qeverisje lidhur me qasjen e planifikuar, kohën e auditimit dhe gjetjet e rëndësishme të auditimit, përfshirë çdo mangësi të rëndësishme në kontrollet e brendshme që kemi identifikuar gjatë auditimit.


Armend Osaj – Auditor Ligjor
ACA – Audit & Consulting Associates
Prishtinë, Kosovë
28 mars, 2024



DOKUFEST

Pasqyra e pozicionit financiar


Për vitin që përfundoi me 31 dhjetor 2023

(Të gjitha vlerat janë prezantuar në EUR)

		31 Dhjetor 2023	31 Dhjetor 2022
PASURITË	Shënime		
Pasuritë qarkulluese			
Paraja dhe ekuivalentet e parasë	3	113,001	292,883
Llogaritë e arkëtueshme	4	4,288	47,976
Stoqet		6,743	5,944
Totali i pasurive qarkulluese		124,032	346,803
Pasuritë jo-qarkulluese			
Prona, impiantet dhe paisjet	5	81,433	55,544
Totali i pasurive jo-qarkulluese		81,433	55,544
TOTALI I PASURIVE		205,465	402,347
REZERVAT DHE DETYRIMET			
Detyrimet afatshkurta			
Llogaritë e pagueshme	6	45,641	5,684
Të hyrat e shtyera	7	109,608	304,944
Totali i detyrimeve afatshkurta		155,249	310,628
Detyrimet afatgjata			
Obligimet për hua, depozita dhe të ngjashme		-	-
Totali i detyrimeve afatgjata		-	-
Rezervat dhe detyrimet			
Fondet në fillim të vitit		91,719	87,025
Teprica/(Mungesa) për vitin		(41,503)	4,695
Totali i Rezervave dhe detyrimeve		50,217	91,719
TOTALI I REZERVAVE DHE I DETYRIMEVE		205,465	402,347


Pasqyrat financiare të përgaditura dhe aprovuara janë nënshkruar më 28 mars 2024 nga:

Linda Llulla-Gashi



Drejtoreshë Ekzekutiv

Eroll Shporta



Përf. Ligjor i autorizuar

Arlind Kirajtani



Menaxher i financave

Shënimet e bashkangjitura nga 1 deri në 13 janë pjesë përbërëse e pasqyrave financiare



DOKUFEST

Pasqyra e të ardhurave gjithëpërfshirëse

Për vitin që përfundoi me 31 dhjetor 2023

(Të gjitha vlerat janë prezantuar në EUR)

		31 Dhjetor 2023	31 Dhjetor 2022
Të hyrat	Shënimi		
Të hyrat	8	1,056,601	841,837
Totali i të hyrave		1,056,601	841,837
Kostoja e mallit të shitur	9	15,292	13,716
Fitimi bruto		1,041,309	828,121
Shpenzimet			
Shpenzimet e pagave	10	300,109	257,900
Shpenzimet administrative	11	757,023	546,997
Shpenzimet e zhvlerësimit	5	25,679	18,008
Totali i shpenzimeve		1,082,811	822,905
Fitimi/ Humbja para tatimit		(41,503)	5,216
Tatimi në fitim		-	521
Fitimi/Humbja Neto		(41,503)	4,695

Shënimet e bashkangjitura nga 1 deri në 14 janë pjesë përbërëse e pasqyrave financiare

DOKUFEST

Pasqyra e ndryshimeve në gjendjen e fondeve

Për vitin që përfundoi me 31 dhjetor 2023

(Të gjitha vlerat janë prezantuar në EUR)

	Teprica/ (Mungesa) për vitin	Totali i Rezervave
Bilanci me 01 Janar 2022	87,025	87,025
Teprica/(Mungesa) për vitin	4,695	4,695
Bilanci me 31 Dhjetor 2022	91,719	91,719
Bilanci me 01 Janar 2023	91,719	91,719
Teprica/(Mungesa) për vitin	(41,503)	(41,503)
Bilanci me 31 Dhjetor 2023	50,217	50,217

Shënimet e bashkangjitura nga 1 deri në 14 janë pjesë përbërëse e pasqyrave financiare

DOKUFEST

Pasqyra e rrjedhës së parasë

Për vitin që përfundoi me 31 dhjetor 2023

(Të gjitha vlerat janë prezantuar në vleren EUR)

	Fundi i vitit 31 Dhjetor 2023	Fundi i vitit 31 Dhjetor 2022
Rrjedha e parasë nga aktivitetet operuese		
Fitimi/Humbja në fillim	(41,503)	4,695
Rregulluar për:		
Zhvlerësimin	25,679	18,008
Ndryshimet në stoqe	(798)	2,241
Ndryshimet në të arkëtueshme	43,688	(34,420)
Ndryshimet në të pagueshme	39,957	(4,183)
Ndryshimet në të pasuritë e tjera	-	-
Ndryshimet në të detyrimet e tjera	-	-
Të hyrat e shtyera	(195,336)	136,789
Paratë e gjeneruara nga operacionet	(135,984)	123,131
Rrjedha e parasë nga aktivitetet investuese		
Blerja e pronës dhe e paisjeve	(54,430)	(42,172)
Pagesa tjera të parasë për aktivitetet investuese	2,861	-
Paraja neto e përdorur në investime	(51,568)	(42,172)
Rrjedha e parasë nga aktivitetet financuese		
Pagesa tjera të parasë për aktivitetet financuese	-	-
Paraja neto e përdorur për aktivitetet financuese	-	-
Ndryshimet neto në para dhe ekuivalent	(179,881)	80,958
Paraja dhe ekuivalentet e parasë më 1 Janar	292,883	211,924
Paraja dhe ekuivalentet më 31 Dhjetor	113,001	292,883

Shënimet e bashkangjitura nga 1 deri në 14 janë pjesë përbërëse e pasqyrave financiare

DOKUFEST

Shënimet e pasqyrave financiare për vitin që përfundoi me 31 dhjetor 2023

(Të gjitha vlerat janë prezantuar në EUR)

1. INFORMATAT GJENERALE

Organizata DOKUFEST është e regjistruar si organizatë joqeveritare sipas ligjit Nr.06/L-43 “Liria e Asociimit në Organizata Joqeveritare” me numër 5102107-0 dhe me numër fiskal 600230255 me seli në Prizren.

Themeluar në vitin 2002, me qëllim të rigjallërimit të kinemasë dhe jetës kulturore në Prizren, DokuFest u rrit dhe u zgjerua në festivalin më të rëndësishëm të filmit dokumentar dhe të shkurtër në Evropën Juglindore dhe nga viti 2019 është festival kualifikues BAFTA për filma të shkurtër. Ekspozita dokumentare fotografike, debate, master klasa dhe performanca muzikore live janë të gjitha pjesë e 9 ditëve të festivalit.

Përveç organizimit të festivalit, DokuFest për një dekadë të tërë është duke implementuar edhe projekte të tjera brenda vitit, të cilat kryesisht kanë të bëjnë me shfrytëzimin e filmave dokumentar si mjete edukuese për çështje të ndryshme që ekzistojnë në shoqërinë tonë, që përfshijnë krijimin e kino klubeve dhe media klubeve të para në shkollat e mesme në Kosovë.

Sot, falë angazhimit të palodhshëm të gjeneratave të rinjëve që kanë kontribuar në rritjen e DokuFest, qyteti i Prizrenit është ndër 10 qytete Europiane me numër më të madh kinemash për kokë banori. DokuFest ka arritur që të edukojë gjenerata të tëra kineastësh të rinjë, që ka kontribuar në ndërkombëtarizimin dhe suksesin e jashtëzakonshëm të kinematografisë kosovare.

DOKUFEST

Shënimet e pasqyrave financiare për vitin që përfundoi me 31 dhjetor 2023

(Të gjitha vlerat janë prezantuar në EUR)

2. BAZA E PËRGATITJES SË PASQYRAVE FINANCIARE DHE POLITIKAT E RËNDËSISHME KONTABËL

2.1. Baza e përgatitjes

2.1.1. Deklarata e pajtueshmërisë

Pasqyrat financiare janë përgatitur në bazë të kontabilitetit në bazë të keshit për të hyrat dhe shpenzimet. Bazat e matjes janë përshkruar në mënyrë më të detajuar në politikat e kontabilitetit të paraqitura më poshtë

2.1.2. Bazat e matjes

Pasqyrat financiare për organizatën janë përgaditur mbi bazën e kostos historike. Kostoja historike në përgjithësi bazohet në vlerën e drejtë të vlerës së dhënë në këmbim të të mirave dhe shërbimeve.

2.1.3. Valuta funksionale dhe e prezantimit

Valuta funksionale e organizatës si dhe e prezantimit të pasqyrave financiare është Euro ("EUR"), e cila është valuta kryesore në Republikën e Kosovës që nga 1 janari 2002.

2.1.4. Përdorimi i vlerësimeve dhe gjykimeve

Përgatitja e pasqyrave financiare në përputhje me ligjet aktuale në fuqi, kërkon që menaxhmenti të bëjë vlerësime dhe supozime që ndikojnë në shifrat e raportuara të pasurive dhe detyrimeve, të ardhurave dhe shpenzimeve. Rezultatet aktuale mund të jenë të ndryshme nga këto vlerësime.

Vlerësimet dhe supozimet rishikohen mbi baza të vazhdueshme. Rishikimet e vlerësimeve njihen në mënyrë prospektive.

2.1.5. Parimi i vijueshmërisë

Pasqyra e pozicionit financiar dhe ajo e të ardhurave gjithëpërfshirëse, janë përgatitur mbi parimin e vijueshmërisë, që supozon se organizata do të jetë në gjendje të realizojë pasuritë e saj dhe t'i mbuloj detyrimet, gjatë rrjedhës normale të operimit.

2.2. Politika të rëndësishme kontabël

2.2.1 Paraja dhe ekuivalentët e parasë

Paraja dhe ekuivalentët e saj përfshijnë paratë në dorë, depozitat e mbajtura në bankë dhe investime të tjera afatshkurtra me likuiditet të lartë me maturime origjinale prej tre muajsh ose më pak.

Transaksionet në valutë të huaj

Transaksionet në valutë të huaj janë transaksione të ndërmarra nga organizata në një valutë të ndryshme nga valuta e saj funksionale. Transaksionet në valutë të huaj përkthehen në valutën funksionale me kursin e këmbimit në datën e transaksionit. Diferencat që rezultojnë nga kursi i këmbimit kalojnë në pasqyrën e të ardhurave gjithëpërfshirëse.

DOKUFEST

Shënimet e pasqyrave financiare për vitin që përfundoi me 31 dhjetor 2023

(Të gjitha vlerat janë prezantuar në EUR)

2.2.2 Llogaritë e arkëtueshme dhe të tjera

Të arkëtueshmet

Të arkëtueshmet fillimisht njihen me vlerën e drejtë dhe më pas mbarten me kosto minus provizionet, nëse ka. Një provizion njihet kur ka dëshmi objektive që organizata nuk do të jetë në gjendje të mbledhë të gjitha shumat e duhura sipas kushteve fillestare të të arkëtueshmeve.

Të arkëtueshmet të shprehura në valutë të huaj prezentohen në valutën Euro duke përdorur kursin e këmbimit në datën e raportimit. Në fund të cdo periudhe raportuese, vlerat kontabël të llogarive të arkëtueshme dhe të tjera shqyrtohen për të përcaktuar nëse ka ndonjë evidencë objektive që shumat nuk janë të rikuperueshme. Nëse është kështu, një humbje nga dëmtimi (rënia në vlerë) njihet menjëherë në pasqyrën e të ardhurave gjithëpërfshirëse.

2.2.3 Stoqet

Stoqet regjistrohen në kontabilitet sipas koston së tyre. Kosto e marrjes përfshin të gjitha shpenzimet e kryera për ta sjellë stokun në vendin dhe kushtet ekzistuese. Në rastin e prodhimit të produkteve në kosto përfshihet edhe pjesa respektive e shpenzimeve të përgjithshme duke u llogaritur mbi kapacitetet normale prodhuese. Kosto e stoqeve llogaritet duke përdorur metodën Kosto Mesatare.

Gjendjet e stoqeve janë të vlerësuara në pasqyrën e pozicionit financiar me koston e tyre historike, duke e konsideruar këtë vlerësim, si vlerën më të ulët midis koston dhe vlerës neto të realizueshme.

Në cdo datë të raportimit, stoqet vlerësohen për rënie të vlerës duke krahasuar vlerën kontabël neto të cdo artikulli të stoqeve (ose grupit të artikujve të ngjashëm) me çmimin e tij të shitjes minus koston e shitjes. Nëse një artikull i stoqeve (ose grupi i artikujve të ngjashme) është i dëmtuar, vlera e tij kontabël reduktohet për çmimin shitës minus koston e shitjes, dhe humbja nga rënia në vlerë njihet menjëherë në pasqyrën e të ardhurave.

Në qoftë se dëmtimi (humbja nga rënia në vlerë) më pas kthehet, vlera kontabël e pasurisë (ose grup pasurish të ngjashme) rritet për vlerësimin e rishikuar të shumës së tij të rikuperueshme (çmimi shitës minus koston e shitjes, në rastin e stoqeve), por jo në tejkalimin e shumës që do të ishte përcaktuar nëse nuk do ishte njohur asnjë humbje nga rënia në vlerë për pasurinë (grup pasurish të ngjashme) në vitet e mëparshme. Një anulim i një humbjeje nga rënia në vlerë njihet menjëherë në pasqyrën e të ardhurave.

2.2.4 Prona, pajisjet dhe impiantet

Prona, pajisjet dhe impiantet janë matur me kosto historike minus zhvlerësimi i akumuluar dhe çdo humbje e akumuluar nga dëmtimi (rënia në vlerë).

Zhvlerësimi ngarkohet në mënyrë që të ndahet kosto e pasurive minus vlera e tyre e mbetur përgjatë jetës së përdorimit të parashikuar, duke përdorur metodën lineare. Normat vjetore të mëposhtme janë përdorur për zhvlerësimin e pronës, impiantëve dhe pajisjeve:

Ndërtesat dhe struktura ndërtimore	5 %
Impiantet dhe makineria e rëndë	10 %
Pajisjet, mobilieritë, kompjuterët	20 %

DOKUFEST

Shënimet e pasqyrave financiare për vitin që përfundoi me 31 dhjetor 2023

(Të gjitha vlerat janë prezantuar në EUR)

Nëse ka një tregues se ka pasur një ndryshim të rëndësishëm në normën e zhvlerësimit, jetën e dobishme ose vlerën e mbetur të një pasurie, zhvlerësimi i kësaj pasurie rishikohet në mënyrë prospektive për të pasqyruar pritshmëritë e reja.

2.2.5 Pasuritë e patrupëzuara / Asetet e paprekshme

Pasuritë e patrupëzuara përcaktohen si softueri kompjuterik i blerë që njihet me koston minus amortizimin e akumuluar dhe cdo humbje të akumuluar nga dëmtimi (rënia në vlerë). Amortizohen gjatë jetës së tyre të llogaritur prej 5 vitesh duke përdorur metodën lineare. Nëse ka një tregues se ka pasur një ndryshim të rëndësishëm në normën e amortizimit, jetës së dobishme ose vlerës së mbetur të një pasurie të paprekshme, amortizimi rishikohet në mënyrë prospektive për të pasqyruar pritshmëritë e reja. Organizata nuk ka pasuri të pa trupëzuara në vitin 2023.

2.2.6 Dëmtimi (rënia në vlerë) i pasurive

Në çdo datë të raportimit, prona, pajisjet dhe impiantet, pasuritë e tjera të paprekshme dhe investimet në pjesëmarrje rishikohen për të përcaktuar nëse ka ndonjë tregues se këto pasuri kanë pësuar ndonjë dëmtim, përkatësisht ndonjë humbje nga rënia në vlerë. Nëse ka një tregues për rënie të mundshme, shuma e rikuperueshme e çdo pasurie të prekur (ose grup pasurish të ngjashme) vlerësohet dhe krahasohet me vlerën e saj kontabël. Në qoftë se shuma e vlerësuar e rikuperueshme është më e ulët, vlera kontabël ulet deri në shumën që vlerësohet se do të merret, ndërsa shuma e dëmtimit (humbja nga rënia në vlerë) njihet menjëherë në pasqyrën e të ardhurave gjithëpërfshirëse.

Fitimi ose humbja që paraqitet me rastin e shitjes ose nxjerrjes nga përdorimi i një pasurie përcaktohet si diferencë midis të ardhurave nga shitja dhe vlerës kontabël neto të një pasurie dhe si rrjedhojë njihet si fitim ose humbje në pasqyrën e të ardhurave gjithëpërfshirëse.

2.2.7 Llogaritë e pagueshme dhe akrualet

Shumat e pagueshme janë matur në kosto që është vlera e drejtë e shumës për t'u paguar në të ardhmen për mallërat dhe shërbimet që janë marrë. Llogaritë e pagueshme janë detyrime në bazë të afateve normale të kreditimit dhe nuk bartin interes. Të pagueshmet të shprehura në valutë të huaj prezentohen në valutën Euro duke përdorur kursin e këmbimit në datën e raportimit. Fitimet ose humbjet e këmbimit valutor janë të përfshira në të ardhurat e tjera apo shpenzimet e tjera.

2.2.8 Njohja e te hyrave

Të hyrat njihen si të ardhura në periudhën kur paguhen. Në fund të vitit sasia e tepërt e të hyrave krahas shpenzimeve trajtohen si bilanc i bartur në periudhën e ardhshme.

2.2.9 Grantet

Grantet e Qeverisë njihen në fitim ose humbje në baza sistematike përgjatë periudhës në të cilën Organizata i njej si shpenzime koston përkatëse për të cilat grantet janë destinuar për kompensim. Në mënyrë specifike grantet e Qeverisë, për të cilat kushti primar është që Organizata duhet të i përfitoj, konstruktoj apo të i njej pasuritë jo-qarkulluese si të hyra të shtyra në pasqyrën e pozitës financiare dhe të transferohen në fitim apo humbje në baza sistematike dhe racionale përgjatë jetës së përdorimit të pasurisë përkatëse.

DOKUFEST

Shënimet e pasqyrave financiare për vitin që përfundoi me 31 dhjetor 2023

(Të gjitha vlerat janë prezantuar në EUR)

Grantet janë njohur vetëm kur ka siguri të arsyeshme se:

- Organizata do të përmbushë të gjitha kushtet e bashkangjitura atyre; dhe
- Grantet do të pranohen.

Grantet operative janë njohur si e hyrë përgjatë periudhës së nevojshme për ti lidhur ato me kostot, për të cilat janë menduar të kompensohen, në bazë sistematike. Grantet e shënuara për përvetësimin e pasurive janë shtyrë dhe njohur si e hyrë përgjatë kohës së përdorimit të pasurisë përkatëse.

2.2.10 Shpenzimet

Shpenzimet e ndodhura janë njohur në periudhën përkatëse në baza të keshit

2.2.11 Provizionet dhe detyrimet e papritura (kontingjente)

Detyrimet e papritura nuk janë njohur në pasqyrat financiare. Ato janë shpalosur vetëm nëse mundësia e rrjedhës së burimeve që përfshijnë përfitime ekonomike është e largët. Aseti kontingjent nuk është njohur në pasqyrat financiare por është shpalosur kur rrjedhja e përfitimeve ekonomike është e mundshme.

DOKUFEST

Shënimet e pasqyrave financiare për vitin që përfundoi me 31 dhjetor 2023

(Të gjitha vlerat janë prezantuar në EUR)

3.PARAJA DHE EKVIVALENTËT E PARASË

	31 Dhjetor 2023	31 Dhjetor 2022
Paraja në bankë	112,622	292,510
Paraja në arkë	379	373
Total paraja dhe ekuivalentët e parasë	113,001	292,883

4. LLOGARITË E ARKËTUESHME DHE TE TJERA

	31 Dhjetor 2023	31 Dhjetor 2022
Të arkëtueshmet	407	407
Parapagimet e furnitorëve	-	42,004
Shpenzimet e parapaguara	94	98
Të arkëtueshme tatimore (Tvsh)	1,975	5,467
Të arkëtueshme tjera	1,812	-
Totali i të arkëtueshmeve	4,288	47,976

DOKUFEST**Shënimet e pasqyrave financiare për vitin që përfundoi me 31 dhjetor 2023**

(Të gjitha vlerat janë prezantuar në EUR)

5. PRONA, IMPIANTET DHE PAISJET

	Toka	Ndërtesa	Pajisjet mobileri kompjuterë	Totali
<i>Kostoja</i>				
Më 1 Janar 2022	-	-	190,341	190,341
Shtesat	-	-	42,172	42,172
Shitjet	-	-	-	-
Më 31 Dhjetor 2022	-	-	232,513	232,513
Më 1 Janar 2023	-	-	232,513	232,513
Shtesat	-	-	54,430	54,430
Shitjet	-	-	(2,861)	(2,861)
Më 31 Dhjetor 2023	-	-	284,082	284,082
Me 1 Janar 2022	-	-	158,961	158,961
Zhvlersimi për vitin	-	-	18,008	18,008
Shlyerje të tjera	-	-	-	-
Më 31 Dhjetor 2022	-	-	176,969	176,969
Me 1 Janar 2023	-	-	176,969	176,969
Zhvlersimi për vitin	-	-	25,679	25,679
Shlyerje të tjera	-	-	-	-
Më 31 Dhjetor 2023	-	-	202,648	202,648
Vlera neto				
Më 31 dhjetor 2022	-	-	55,544	55,544
Më 31 dhjetor 2023	-	-	81,433	81,433

DOKUFEST

Shënimet e pasqyrave financiare për vitin që përfundoi me 31 dhjetor 2023

(Të gjitha vlerat janë prezantuar në EUR)

6. LLOGARITË E PAGUESHME

	31 Dhjetor 2023	31 Dhjetor 2022
Llogaritë e pagueshme	42,178	1,781
Taksa e pagueshme (tatimit në paga, qira etj)	3,463	3,903
Totali i llogarive të pagueshme	45,641	5,684

7. TË HYRAT E SHTYERA

	31 Dhjetor 2023	31 Dhjetor 2022
SIDA	65,067	128,220
EU - How Do I See You	-	31,919
KK Projekt	13,684	11,061
NED 0636	12,765	22,891
The Kingdom of Netherlands Matra+	10,399	-
British Council	10,773	-
Smart Balkans	7,464	-
Goethe Institut Sarajevo	7,341	-
Komuna e Prizrenit	(240)	-
GIZ - Digital Skills Factory	(17,138)	21,545
Ambasada Holandeze - Projekt	(65)	12,099
MKRS projekt	(98)	-
Rockfeller Brothers Fund	(293)	-
Qendra Kinematografike e Kosoves	(51)	-
Prince Claus Fund	-	-
Te hyrat e shtyera tjera	-	77,208
Totali i të hyrave të shtyera	109,608	304,944

DOKUFEST

Shënimet e pasqyrave financiare për vitin që përfundoi me 31 dhjetor 2023

(Të gjitha vlerat janë prezantuar në EUR)

8. TË HYRAT

	31 Dhjetor 2023	31 Dhjetor 2022
Të hyrat nga shitja	125,868	88,474
Donacionet	930,733	753,363
Totali i të hyrave	1,056,601	841,837

9. KOSTOJA E MALLIT TË SHITUR

	31 Dhjetor 2023	31 Dhjetor 2022
Stoqet në fillim	5,944	8,186
Blerjet gjatë vitit	16,091	11,474
Stoqet në fund	6,742	5,944
Total kosto e mallit të shitur	15,292	13,716

10. SHPENZIMET E PAGAVE

	31 Dhjetor 2023	31 Dhjetor 2022
Shpenzimet e pagave bruto	285,879	245,623
Kontributet për Sigurim Pensional	14,230	12,276
Totali i shpenzimeve të pagave	300,109	257,900

DOKUFEST

Shënimet e pasqyrave financiare për vitin që përfundoi me 31 dhjetor 2023

(Të gjitha vlerat janë prezantuar në EUR)

11. SHPENZIMET ADMINISTRATIVE

	31 Dhjetor 2023	31 Dhjetor 2022
Shpenzimet e materialit	7,050	6,767
Shpenzimet për pajimet deri 1000 Euro	10,662	5,430
Shpenzimet për skenografi	40,713	40,394
Shpenzimet e performimit	63,686	37,925
Shpenzimet e zërimit	17,830	13,666
Shpenzimet e shërbimeve	10,020	5,428
Shpenzimet e reklamës dhe marketing	2,000	17,772
Shpenzimet e përfaqsimi	38,555	30,972
Shpenzimet e web dizajn	9,198	17,854
Shpenzimet e shërb. nga jorez.5%	44,659	8,529
Shpenzimet për qira	18,892	20,029
Shpenzimet për të drejta autoriale	16,274	19,755
Shpenzimet komerciale	47,878	34,728
Shpenzimet e pazbritshme	36,964	31,318
Shpenzimet e transportit	22,251	14,017
Shpenzimet për përkthim	19,428	21,810
Shpenzimet për hotel	64,399	54,211
Shpenzimet për projekte	90,642	49,021
Shpenzimet për udhëtim të mysafireve-biletat	50,125	33,207
Shpenzimet për prov.bankar	6,819	7,634
Shpenzimet për udhëtim zyrtar	11,258	13,647
Shpenzimet për automjete	1,526	2,010
Shpenzimet për rrymë,tel., inter.,etj	4,069	5,073
Shpenzimet për video	6,350	7,280
Shpenzimet për subgrantet	24,520	10,000
Shpenzimet për zhvillim strategjik, hulumtim dhe ndikim ekonomik	20,999	-
Shpenzimet tjera	70,257	38,520
Totali i shpenzimeve administrative	757,023	546,997

DOKUFEST

Shënimet e pasqyrave financiare për vitin që përfundoi me 31 dhjetor 2023

(Të gjitha vlerat janë prezantuar në EUR)

12. SHPENZIMET ADMINISTRATIVE

Nr.	Donacionet	2023	2022
1	National Endowment for democracy	68,485	81,946
2	Swedish International Development for Agency -SIDA	86,471	137,626
3	Komuna e Prizrenit - festival	70,000	30,000
4	Rockefeller Brothers Fund	32,427	31,451
5	EU - How Do I See You		105,402
6	GIZ - Digital Media Club		48,125
7	Prince Claus Fund	28,000	-
8	AMB.Holandeze Projekti Matra Plus	79,944	-
9	AMB. HolandezeProjekti Matra KIST	8,738	-
10	Ambasada Franceze	4,000	-
11	Pro Credit Bank	77,600	70,000
12	Ambasada Gjermane	3,000	3,000
13	Ipko Foundation		3,000
15	Ministria Kultures Rinise dhe Sportit - MKRS	100,000	98,000
16	UNDP		7,000
17	Kuvendi Komunal Prizreni - Projekt	48,551	77,103
18	Ambasada Austriake	3,006	2,383
19	Qendra Kinematografike e Kosoves	6,000	-
20	The Swiss Federal Department of Foreign Affairs - FDFA	9,994	8,996
21	MERDIAN	3,500	-
22	Ambasada e Finlandes	700	-
23	Smart Balkan	9,575	-
24	British Council	19,979	-
25	Ambasada Izrael	606	-
26	Kosmonte	10,000	-
27	Goethe Institute	10,000	-
28	Royal Beverage LLC	5,000	4,021
29	Kontakt Shpk		49,844

DOKUFEST

Shënimet e pasqyrave financiare për vitin që përfundoi me 31 dhjetor 2023

(Të gjitha vlerat janë prezantuar në EUR)

30	Neptun Shpk	20,000	30,000
31	Ministria e Puneve te Jashtme		11,500
32	UNICEF		14,010
33	Ambasada Holandeze		37,482
34	Bucaj SHPK	7,000	13,000
35	Komuna e Prizrenit	6,000	20,970
36	Ambasada Britanike	4,692	
36	DoC Dream - republika Ceka	1,969	
36	Kooperativa - Regioanl Platform for culture	800	
36	DEO-Democracy in Europe Enlightenment		144
36	JT International Luxemburg	9,355	
37	Sporting NT- Fatmir Godeni		1,500
38	Gekos Shpk		1,500
39	The Foundation Manifesta		2,150
	Totali I Donacioneve	735,392	890,152

DOKUFEST

Shënimet e pasqyrave financiare për vitin që përfundoi me 31 dhjetor 2023

(Të gjitha vlerat janë prezantuar në EUR)

13. KONTIGJENCAT DHE ZOTIMET

13.1. Çështjet ligjore

Për vitin e mbyllur me 31 dhjetor 2023 organizata nuk ka ndonjë detyrim kontingjent që kërkon shpalosje në pasqyrat financiare të saj.

14. NGJARJET PAS DATËS SË RAPORTIMIT

Nuk ka ngjarje domethënëse pas datës së raportimit që mund të kërkojnë rregullime ose shpalosje në pasqyrat financiare.